

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Platformat elektronike të Tregtimit dhe Klerimit Shqipëri-Kosovë, për tregjet e energjisë elektrike dhe bashkimin e tregjeve”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

48211000-0 – Paketa software për platforma ndërlidhëse

VLERA E FONDIT LIMIT:

300,000,000.00 (treqind milionë) Lekë, pa TVSH ose

Vlera në Euro: 3,131,524 Euro (tre milion e njëqind e tridhjetë një mijë e pesëqind e njëzet e katër) pa TVSH, sipas kursit të këmbimit të datës 10.04.2026, 1 Eur = 95.80 Lek.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Mos ndarja në lote e kësaj kontrate është e mbështetur në bazën ligjore si vijon:

A. Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i cili parashikon se:

Neni 3, Përkufizime, “Tregu i organizuar i energjisë elektrike” është platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë.

Neni 57, pika 1 Operimi i tregut, Operimi i tregut të energjisë elektrike kryhet nga operatori i tregut, i licencuar nga ERE . “Operatori i tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, në bazë të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe për të gjitha aktivitetet e lidhura me të, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financiar (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut. Operatori i tregut do të jetë Bursa Shqiptare e Energjisë.”

Neni 57, pika 1/3. Operatori i Tregut pa kufizim, mund të nënkontrakttojë palët e treta, me qëllim ofrimin e shërbimeve për operimin e platformës elektronike të tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda së njëjtës ditë, si dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me të, përfshirë shërbimet e

pagesave dhe kompensimit financiar (clearing) të pjesëmarrësve të tregut. Këto palë të treta duhet të jenë operatorë ndërkombëtarë me reputacion të mirë, me përvojë të gjatë në tregjet e huaja për ofrimin e shërbimeve të ngjashme, në përputhje me modelin e tregut shqiptar dhe rregullat e tregut. Në rastet kur një ose disa institucione të Republikës së Shqipërisë, ose ente/shoqëri publike të themeluara sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë nuk zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të regjistruar të operatorit të tregut dhe /ose nuk kontrollojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të lidhura me aksionet në kapitalin e operatorit të tregut dhe /ose nuk emërojnë më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit të administrimit apo këshillit mbikëqyrës të operatorit të tregut, operatori i tregut nuk është autoritet kontraktor, në kuptim të pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe për pasojë nuk i nënshtrohet fushës së zbatimit të atij ligji.

- B. Mos ndarja në lote e kësaj kontrate është e mbështetur në VKM Nr. 519, datë 13.7.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, të ndryshuar me VKM Nr. 872, datë 27.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 519, datë 13.7.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, ku parashikohet si vijon:

Në këto VKM, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Operatori i Tregut - Bursa Shqiptare e Energjisë (BSHE)” është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe operimin e tregut të organizuar me shumicë të energjisë elektrike nëpërmjet platformës elektronike të tregutimit, platformës elektronike të klerimit dhe të shlyerjeve financiare për tregjet e ankandeve të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe tregjeve të vazhdueshme brenda së njëjtës ditë, ndërmjet anëtarëve të Bursës, në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike”

1. Qëllimet dhe objektivat e modelit të tregut

Të krijojë kushtet për një treg të orientuar drejt importit dhe eksportit, që promovon përfitimet e konsumatorëve, si dhe përfitime për sektorin shqiptar të energjisë elektrike, duke ofruar fleksibilitet për integrimin në tregun e energjisë elektrike panevropiane dhe bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (day ahead market) dhe tregut brenda ditës (intraday market);

Modeli Shqiptar i Tregut synon përmbushjen e objektivave të qeverisë së Shqipërisë në drejtim të:
i) liberalizimit të plotë të tregut të energjisë elektrike dhe krijimit të një tregu/tregjeve të organizuar, pra një treg/tregje konkurrues/e të energjisë për tregtimin e flukseve fizike të ditës në avancë apo brenda ditës;

Objektivi përfundimtar i modelit të tregut është të integrojë tregun energjetik shqiptar në bashkimin e tregut pan evropian.

- Sa më sipër, rezulton që Ligji Nr. 43/2015 në nenin 57, pika 1 përcakton se tregu i organizuar i energjisë elektrike bëhet nëpërmjet platformës së organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike, në bazë të tregjeve të ditës në avancë dhe avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë. Pra është kërkuar vetëm një Platformë për të këto tregje.
- Neni 57, pika 1/3 përcakton se Ofruesi i shërbimit që ofron platformën e tregtimit duhet të ofrojë dhe shërbimet e ndërlidhura me të, përfshirë shërbimet e pagesave dhe kompensimit financiar (clearing). Pra këto platforma janë të ndërlidhura edhe me njëra tjetrën me qëllim kryerjen e sigurt të shërbimeve të tregtimit, shërbimeve të pagesave dhe kompensimit financiar (clearing).
- VKM Nr. 519 e ndryshuar, përcakton që “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” është platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë
- VKM Nr. 519 e ndryshuar, përcakton që objektivi përfundimtar i modelit të tregut është të integrojë tregun energjetik shqiptar në bashkimin e tregut panevropian. Nuk njihet asnjë model tjetër në Evropë përveç këtij modeli që ne po ndjekim, ku energjia shitet dhe blihet nëpërmjet një platforme për të gjitha tregjet që aplikohen në atë vend. Në të kundërt ky objektivi do të ishte i pamundur për tu realizuar.

AK gjykon se ndarja në lote e kontratës së mësipërme nuk është opsjon që ligji dhe aktet nënligjore e pranojnë pasi Neni 3, Përkufizime, shprehet se “Tregu i organizuar i energjisë elektrike” është platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktor është një institucion i rëndësishëm së veçantë në sistemin elektro-energjetik shqiptar dhe çdo vonesë në realizimin e kontratës sjell dëme të mëdha në tregun e organizuar të energjisë elektrike kombëtare dhe tashmë dhe ndërkombëtare.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX SHA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10.
- b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas pikës 1 të kësaj Shtojce.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro minimale vjetore, gjatë vitit të fundit financiar, në një vlerë të paktën prej 120,000,000 (njëqind e njëzetë milion) Lekë pa TVSH.

Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklaratës të xhiros vjetore ose të pasqyrave financiare, të realizuara nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

OE duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim është argumentuar se vlera e xhiros për vitin e fundit financiar të jetë në masën 120,000,000 (njëqind e njëzetë milion) Lekë pa TVSH. Xhiro minimale vjetore është kërkuar në maksimumin e saj sipas parashikimeve ligjore në vlerën 40% të vlerës së kontratës, për shkak të rëndësisë së kontratës për Autoritetin Kontraktor, i cili duhet të garantohet mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar të Operatorit Ekonomik ofertues.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme me një vlerë prej 120,000,000 (njëqind e njëzetë milion) Lekë.

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmitë e mëposhtme:

- Kur Operatori Ekonomik ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se **40 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë numrin e kufizuar të operatorëve ekonomik që ofrojnë këto lloj shërbimesh, sasinë dhe cilësinë e shërbimit objekt procedure prokurimi, është menduar që vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë kontrata të ngjashme, të jetë 40% e vlerës dhe në këtë mënyrë,

AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Ofertuesi (operatori ekonomik) duhet të deklarojë të gjithë personelin teknik dhe profesional të cilët do të angazhohen në realizimin e këtij projekti të rëndësishëm të Autoritetit Kontraktor.

Përbërja e personelit duhet të përfshijë të paktën:

- një Menaxher Projekti
- një zëvendës Menaxher Projekti
- një Ekspert i Tregut të Ditës në Avancë
- një Ekspert i Tregut Brenda së Njëjtës Ditë
- një Ekspert i Klerimit dhe Shlyerjes.

Disponimi i punonjësve të kërkuar do të dëshmohet nga Operatori Ekonomik nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST. Në rastin e shpalljes fitues, OE do të paraqesë:

- CV për secilin personel të deklaruar që provojnë përvojën e tyre në fushën e tyre të ekspertizës
- Dokument i lëshuar nga Ofertuesi që konfirmon marrëdhënien midis personelit dhe Ofertuesit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Argumentimi bazohet në arsyetimin që Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike është në operim në të dyja tregjet, DAM dhe IDM, në Zonën e Ofertimit të Shqipërisë dhe në Zonën e Ofertimit të Kosovës. Me qëllim garantimin e vazhdimësisë së funksionalitetit në cilësi dhe në kohë kërkohet realizimi me sukses i projektit në tërësi, në kuadër të planifikimit, implementimit, integritimit në tregjet SDAC dhe SIDC/XBID dhe monitorimit sa më saktë nga ana e Ofruesit të Shërbimit të fazave të projektit. Konsiderohet si domosdoshmëri kualifikimi i lartë organizativ dhe teknik, si dhe eksperiencia e provuar e personave që do mbulojnë pozicionet e sipërpërmendura me qëllim realizimin e detyrave siç duhet dhe brenda afateve.

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.3.3 Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të jetë Bursë e Energjisë, me përvojë në operimin/menaxhimin e aktivitetit të tregut të bursës së energjisë elektrike (Tregu i Ditës në Avancë, Tregu Brenda së Njëjtës Ditë dhe Bashkimi i Tregjeve) ku zbatohet Modeli i Synuar European.

Ofertuesi duhet të provojë plotësimin e kërkesave duke paraqitur:

- Licenca dhe/ose akte të lëshuara nga Organi kompetent i shtetit ku Ofertuesi është regjistruar apo shtetit përkatës ku është licencuar (p.sh. Autoriteti përkatës Rregullator i Energjisë), që autorizon Ofertuesin për të ushtruar veprimtarinë e operimit/menaxhimit të tregut të energjisë (të Tregut të Ditës në Avancë dhe të Tregut Brenda së Njëjtës Ditë).

Nëse Licenca/akti nuk lëshohet në shtetin përkatës, Ofertuesi, duhet të paraqesë konfirmim me shkrim, nga institucioni/organi përkatës, në shtetin e tij dhe/ose rajonet përkatëse të veprimtarisë (p.sh. Autoriteti Rregullator, Ministri etj.), që kryen veprimtari të operimit/menaxhimit në tregjet përkatëse të këtyre shteteve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar si dhe bazuar në Ligjin Nr. 43/2015, i ndryshuar, “PËR SEKTORIN E ENERGISË ELEKTRIKE” ku në nenin 57, pika 1 përmendet që *“Operatori i tregut është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut, në bazë të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, si dhe për të gjitha aktivitetet e lidhura me të, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financiar (clearing) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut. Operatori i tregut do të jetë Bursa Shqiptare e Energjisë.”* Gjithashtu, në pikën 1/3 të po këtij neni përmendet që *“Operatori i Tregut pa kufizim, mund të nënkontraktojë palët e treta, me qëllim ofrimin e shërbimeve për operimin e platformës elektronike të tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda së njëjtës ditë, si dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me të, përfshirë shërbimet e pagesave dhe kompensimit financiar (clearing) të pjesëmarrësve të tregut. Këto palë të treta duhet të jenë operatorë ndërkombëtarë me reputacion të mirë, me përvojë të gjatë në tregjet e huaja për ofrimin e shërbimeve të ngjashme, në përputhje me modelin e tregut shqiptar dhe rregullat e tregut.”*

Ky argumentim përputhet dhe me përvojën e mëparshme të ALPEX gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit të mëparshme në zgjedhjen e Ofruesit të Shërbimit të Platformave.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Licensa dhe/ose akti i lëshuar nga Organi kompetent i shtetit (p.sh Autoriteti përkatës Rregullator i Energjisë) ku Ofertuesi është regjistruar apo në shtetin përkatës ku është licencuar është dokumenti i cili vërteton faktin që Ofruesi i shërbimit i përzgjedhur do jetë Bursë e Energjisë. Kjo nuk është një licencë teknike por akt nëpërmjet të cilit njihen të drejtat e operimit/menaxhimit të tregut të energjisë Ofruesit të Shërbimit për këtë procedurë prokurimi.

(shënim- nëse është rasti, shtoni argumentimin nga ana teknike për nënlojin/kodin/kategorië e kërkuara të licencës përkatëse, bazuar në shërbimet objekt kontrate)

2.3.4 Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të jetë anëtar i bashkimit rajonal të çmimeve (PCR - Price Coupling of Regions) në mënyrë që ti garantojë ALPEX-it nëpërmjet algoritmit (aktualisht EUPHEMIA) të llogarisë çmimet e energjisë elektrike dhe alokimin e kapaciteteve ndërkufitare në bazë të Procedurave Operacionale të ALPEX.

Për të provuar përmbushjen e kësaj pike, Ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim, e cila përmend që ai është anëtar i bashkimit rajonal të çmimeve (PRC - Price Coupling of Regions) dhe ka të drejtat për të ofruar akses për përdorimin e të dhënave të tregjeve të ALPEX në këtë algoritëm (aktualisht Euphemia) në mënyrë që të prodhojë rezultatet e tregimit për tregun e izoluar dhe/ose bashkimin e tregjeve, sipas Procedurave Operacionale të ALPEX.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 41, pika 4, gërma a.) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Referuar Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, si dhe VKM Nr. 519, datë 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” i ndryshuar me VKM Nr. 872, datë 27.12.2022, si dhe bazuar në Dokumentin e Politikës Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” në kuadër të instrumentit të Bashkimit Europian, si dhe Vendimeve të Entit Rregullator për përshpejtimin e integritetit të tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë në tregun e vetëm Europian, kërkohet në mënyrë absolute që qasja e të dhënave të tregimit të ALPEX në bashkim tregjesh behët nëpërmjet algoritmit Europian, i cili administrohet nga anëtarët e vetë të Bashkimit Rajonal të Çmimit (PRC - Price Coupling of Regions). E vetmja mënyrë për qasjen në këtë algoritëm është nëpërmjet një Anëtari të Bashkimit Rajonal të Çmimit (PRC - Price

Coupling of Regions). Vetë ky shërbim përmban edhe faza të caktuara të projektit, ku përshkruhet që ALPEX do të marrë shërbime nga Ofruesi i Shërbimit për tu integruar në Tregun e vetëm European SDAC dhe SIDC. Procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin European, konkretisht kapitulli 15 “Energjia” obligon Shqipërinë që Tregu i organizuar i energjisë elektrike të përshtatet me standardin European me destinacion integrimin në SDAC dhe SIDC.

2.3.5 Ofertuesi (Operatori Ekonomik) duhet të operojë Platforma Tregtimi dhe Klerimi të Energjisë Elektrike për Tregun e Ditës në Avancë, të cilat janë ndërtuar në përputhje me Modelin e Synuar European, për tu integruar në Tregun e Vetëm të Bashkuar të Ditës në Avancë (Single Day Ahead Coupling – SDAC). Këto Platforma, Tregtimi dhe Klerimi duhet të përfshijnë edhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, i cili duhet të jetë në përputhje me Modelin e Synuar European, për tu integruar në Tregun e Vetëm të Bashkuar Brenda së Njëjtës Ditë (Single Intra Day Coupling – SIDC/ XBID).

Për të provuar përmbushjen e kësaj pike, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- i. Një konfirmim zyrtar i lëshuar nga të paktën një Bursë Evropiane e Energjisë e shërbyer, ose një vetëdeklarim me shkrim në rastet kur platforma është në pronësi të operatorit ekonomik përkatës, që konfirmon operimin e Tregut të Ditës në Avancë (DAM), i cili është i përshtatshëm për integrimin e plotë në SDAC dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë (IDM) dhe i përshtatshëm për integrimin e plotë në SIDC/XBID.
- ii. Një konfirmim zyrtar i lëshuar nga të paktën një Bursë Evropiane e Energjisë e shërbyer, ose një vetëdeklarim me shkrim në rastet kur platforma është në pronësi të operatorit ekonomik përkatës, që konfirmon operimin e një Platforme Klerimi për të mundësuar klerimin e transaksioneve për Tregun e Ditës në Avancë dhe Brenda së Njëjtës Ditë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 41, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe bazuar në Ligjin Nr. 43/2015, i ndyshuar, PËR SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE ku në nenin 57, pikën 1/3 përmendet “...Këto palë të treta (Ofruesit e Shërbimit) duhet të jenë operatorë ndërkombëtarë me reputacion të mirë, me përvojë të gjatë në tregjet e huaja për ofrimin e shërbimeve të ngjashme, në përputhje me modelin e tregut shqiptar dhe rregullat e tregut.”

(shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Kërkesa për një Platformë të përshtatshme Tregtimi dhe Klerimi për Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë, bazohet edhe në Ligjin Nr. 43/2015, i ndyshuar, PËR SEKTORIN E ENERJISË ELEKTRIKE, ku në nenin 57 në pikën 1/3 përmendet që “Operatori i Tregut pa kufizim, mund të nënkontrakttojë palët e treta, me qëllim ofrimin e shërbimeve për operimin e platformës elektronike të tregut të ditës në avancë dhe tregut brenda së njëjtës ditë, si dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me të, përfshirë shërbimet e pagesave dhe kompensimit financiar (clearing) të pjesëmarrësve të tregut.” Këto kërkesa bazohen edhe në

Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike të miratuara me Vendimin e Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, të ndryshuar.

Sa më sipër, duke qënë se ALPEX është një Bursë në funksion, kërkon që Operatori Ekonomik të ketë eksperiencë në operimin e Platformës, e cila garanton implementimin me sukses të projektit.

2.3.6 Në funksion të plotësimit të Shtojcës 10 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar si dhe vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, Autoriteti Kontraktor ALPEX sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atësi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personit. (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërishit çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e Referencës për objektin: “Platformat elektronike të Tregtimit dhe Klerimit Shqipëri-Kosovë, për tregjet e energjisë elektrike dhe bashkimin e tregjeve” janë hartuar nën frymën e Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, VKM Nr. 519, datë 13.7.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, të ndryshuar me VKM Nr. 872, datë 27.12.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 519, datë 13.7.2016 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike” e cila sipas këtij modeli synon të krijojë kushtet për një treg të orientuar drejt importit dhe eksportit, që promovon përfitimet e konsumatorëve, si dhe përfitime për sektorin shqiptar të energjisë elektrike, duke ofruar fleksibilitet për integrimin në tregun e energjisë elektrike pan evropiane dhe bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (day ahead market) dhe tregut brenda ditës (intraday market).

ALPEX, sipas vendimeve të organeve drejtuese të tij po organizon Tregun me shumicë të energjisë elektrike edhe për Zonën e Ofertimit të Kosovës. Për të mundësuar këtë, ALPEX është pajisur me të gjitha lejet dhe licensat e nevojshme.

Termet e Referencës janë hartuar në përputhje të plotë me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara nga Enti Rregullator i Energjise me Vendim e Bordit Nr. 347, Datë 27.12.2022 “Mbi për Miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX Përkufizimet, Procedura e Tregtimit si dhe Procedura e Klerimit dhe Shlyerjes)” të ndryshuar, të miratuara edhe nga Zyra e Rregullatorit për Energji e Kosovës (ZRRë), Marrëveshjet Operacionale të firmosura nga Komitetet Drejtuese të bashkimit të Tregut të Ditës në Avancë (day ahead market) dhe Tregut Brenda së Njëjtës Ditë (intraday market), si dhe në eksperiencën e deritanishme që ALPEX ka krijuar gjatë viteve të operimit të tregjeve si për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë ashtu edhe të Zonës së Ofertimit të Kosovës dhe bashkimit të tregjeve Shqipëri – Kosovë.

Termat e Referencës janë bërë duke marrë parasysh synimin që ka Shqipëria dhe Kosova për tu integruar në Tregun e Vetëm Evropian të Ditës në Avancë SDAC dhe Tregun Brenda së Njëjtës Ditë SIDC.

Afatet e integrimi në këto Tregjeve të bashkuara janë të përcaktuara në Agjendën e Reformës, specifikisht në kapitullin nr. 15 për Energjinë, në përputhje me angazhimet që ka marrë qeveria Shqiptare për vazhdimin e reformave dhe vazhdimin e integritit të tregut në SDAC dhe SIDC.

Qeveria Shqiptare, me anë të Dokumentit “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024-2027” në kuadër të Instrumentit të Bashkimit Evropian “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”, referuar pikës R-4.1.1 “Përafrimi me paketën e integritit të energjisë elektrike për të mundësuar integrimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë, krijimin e tregut të energjisë elektrike brenda ditës (intra day), operacionalizimin e paketës në përputhje me planin e integritit të operatorëve për bashkim të tregjeve deri në vitin 2025”, citon si vijon:

ALPEX është një Bursë tashmë në funksionim, i cili ka përzgjedhur një nga anëtarët e Price Coupling Regional (PCR) si ofrues shërbimi, për të aksesuar shërbimin e algoritmit evropian për llogaritjet e çmimeve, vëllimeve dhe fluksit të energjisë. Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri po kalon reforma të rëndësishme për t'u përafruar me standartet e Bashkimit Evropian (BE) dhe për tu integruar në nismën Bashkimi i Tregut të Ditës në Avancë (SDAC). ALPEX ka hartuar rregullat e tregut në përputhje me modelin evropian, duke përfshirë kryesisht dispozitat në Rregulloren (BE) 2019/943. Shqipëria po bashkëpunon me vendet fqinje dhe Operatorët e Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO-ve) për të zbatuar zgjidhjet e bashkimit të tregut, ku bashkimi i tregut Shqipëri – Kosovë DAM është një rast i tillë i integritit.

Në kuadër të integritit, pas aprovimeve nga Entet Rregullatore të Energjisë të vendeve përkatëse, Operatorët e Sistemit të Transmetimit dhe Operatorët e Emëruar të Energjisë Elektrike (NEMO) të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë kanë rënë dakord dhe kanë themeluar Projektin SEE Initiatives Project për të punuar së bashku për integrimin e këtyre tregjeve me SDAC nëpërmjet kufirit të Greqisë. Ky proces do të implementohet nëpërmjet tavolinës së punës Italian Border Working Table (IBWT). Në këto momente, ALPEX ka statusin e vëzhguesit në këtë tavolinë.

Aktualisht, ALPEX operon Tregun e Ditës në Avancë dhe Tregun e Ankandëve Brenda së Njëjtës Ditë si bashkim tregjesh Shqipëri – Kosovë. Termat e Referencës kanë për qëllim që ky aktivitet të vazhdojë edhe me Ofruesin e ri të Shërbimit, duke përfshirë dhe integrimet e lartpërmendura.

Bazuar në Ligjin Nr. 25/2024 “Për sigurinë kibernetike”, Autoriteti Kontraktor në cilësinë e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), është përcaktuar si pjesë e Sektorit me kritikabilitet të lartë. Si rrjedhojë, ALPEX-it i linden detyrime në zbatimin e këtij ligji, të cilat janë mbajtur parasysh kur janë hartuar Termat e Referencës.

Në Termat e Referencës janë marrë në konsideratë produktet, llojet e urdhërporosive si dhe rezolucioni i operimit të tregjeve për të dy Zonat e Ofertimit në përputhje të plotë me Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike.

Është kërkuar që Platforma e Tregtimit dhe Klerimit të jenë të konfigurueshme dhe të menaxhueshme nga ana e stafit të trajnuar të ALPEX, në mënyrë që operimi i këtyre Platformave si dhe të gjitha hapave të tyre në funksion të operimit të rregullt të tregjeve të bëhet në mënyrë automatike si dhe në rast të problematikave të ndërlidhjes ndërmjet platformave të bëhet e mundur edhe ndërhyrja manuale duke bërë download apo upload të file-ve përkatëse në funksion të zgjidhjes së problematikave, por gjithmonë në respekt të plotë të Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, marrëveshjeve operacionale të nënshkruar ndërmjet OST-ALPEX-KOSTT, si dhe Procedurës Operacionale të nënshkruar ndërmjet OST-ALPEX-KOSTT.

Termat kanë marrë në konsideratë kalimin nga rezolucioni në 60 min, në 15 min për Zonën e Ofertimit të Shqipërisë bazuar në Vendimin e Entit Rregullator të Shqipërisë që i kërkon ALPEX-it kalimin në këtë rezolucion. Ndërkohë, në Zonën e Ofertimit të Kosovës ky rezolucion fillimisht do të jetë 60 min për të kaluar më pas në rezolucionet e tjera deri në 15 min.

Implementimi i dy tregjeve ekzistuese që operohen nga ALPEX, kërkon përfshirjen e aktorëve të tretë siç janë:

1. OST-të për çdo Zonë Ofertimi;
2. Bankat për Shlyerje për çdo Zonë Ofertimi;
3. Anëtarët e Bursës për çdo Zonë Ofertimi;
4. Anëtarët e Përgjithshëm të Klerimit për çdo Zonë Ofertimi;
5. Shpërndarësi i të Ardhurave të Kongjestionit.

Disa nga këta aktorë, kanë sistemet e tyre të cilat duhet të integrohen me sistemet e ALPEX. Për këtë qëllim kërkohet fillimisht punë përgatitore për përgatitjen dhe konfigurimin e Platformave sipas kërkesave teknike.

Në funksion të përdorimit të lehtë dhe të shpejtë nga ana e Anëtarëve të Bursës, është kërkuar që aplikacioni apo aksesit dhe përdorimi i Platformave nga Agjentët Tregtare të Anëtarëve të Bursës dhe Agjentët Klerues të Anëtarëve të Klerimit të jetë i thjeshtë dhe miqësor me përdoruesin (user friendly). Nëpërmjet këtij aksesit Agjentët mund të marrin të gjithë informacionin e mundshëm sipas përcaktimeve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike si dhe të kenë hapësirat e nevojshme për vendosjen e Urdhërporosive sipas përshkrimeve në këto Rregulla, apo dhe të modifikojnë në kohë reale kufirin e kreditit. Duke pasur parasysh edhe interesimin e Anëtarëve të Bursës apo edhe praktikave Evropiane të Bursave Evropiane të cilat ofrojnë lehtësirat e mundshme për aksesin nga sistemet e tyre në platformën e tregtimit nëpërmjet API, është kërkuar që të ofrohet edhe ky shërbim. Është kërkuar që të dhënat duhet zbatojnë të njëjtat mekanizma për kontrollin e aksesit dhe autorizimit mbi sigurinë e të dhënave.

Në kuadër të mbarëvajtjes së rregullt të të gjithë procesit të tregtimit dhe klerimit është kërkuar që Platformat të jenë në standardin më të lartë të mundshëm të sigurisë sa i përket parandalimit të akseseve apo ndërhyrjeve nga jashtë, duke përfshirë këtu edhe sulmet kibernetike për shkak të përcaktimit të infrastrukturës së NEMO (ALPEX) si infrastrukturë kritike kombëtare në sektorin e energjisë elektrike sipas Ligjit të lartpërmendur.

Në vijim, është kërkuar që ndërlidhja e Platformave të ALPEX me Platformat elektronike të aktorëve të sipërpërmendur, të bëhet përmes një teknologjie VPN IPsec site to site. Po ashtu, qasja në Platformën e Tregtimit është kërkuar të krijohet duke përdorur një sistem për lidhje të sigurt dhe vërtetim të përdoruesve me metodat e mëposhtme, por pa u limituar në ato:

- Certifikata SSL
- Autentifikimi me 2 faktorë duke përdorur një aplikacion celular/sms për konfirmim shtesë të identitetit.

Autentifikimi dhe autorizimi i përdoruesit është kërkuar të menaxhohet nëpërmjet shërbimeve LDAP (p.sh., Active Directory) ku të gjitha veprimet e përdoruesit të regjistrohen për qëllime auditimi.

Në mënyrë që Platforma të mund të komunikojë me Platformat e tjera elektronike të përmendura në Termat e Referencës është kërkuar që të gjitha formatet e fileve që komunikojnë me njëra-tjetrën të jetë xml, të aprovuara nga ENTSO-E. Në lidhje me integrimin e tregjeve aktuale në tregjet evropiane në rast të ndonjë ndryshimi në të ardhmen, është kërkuar që Ofruesi i Shërbimit të marrë përsipër kthimin e tyre sipas formatit të duhur që përdorin Bursat Evropiane në operimin në tregun SDAC dhe SIDC/XBID.

Për shkak të detyrimeve për publikim që rrjedhin nga parashikimet e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, si dhe atyre për transparencë, është kërkuar që sistemet të suportojnë funksionalitetin e raportimit duke përfshirë konceptimin ose dizejnimin e raporteve dhe gjenerimin e tyre.

Është kërkuar që raportet të mund të gjenerohen nga ekzekutimi i proceseve (për shembull: një herë në javë) ose dhe manualisht si dhe këto raporte të ruhen në sistem në formate të printueshme (pdf) dhe në formate për përdorim të jashtëm – pasi eksportohet nga sistemi (format word, excel, csv, xml etj).

Në funksion të operimit të tregjeve është kërkuar që Platforma duhet të konceptohet dhe zhvillohet për të qenë në gjendje pune të vazhdueshme dhe të pandërprerë 24/7/365.

Në këtë funksion është kërkuar që të bëhet dhe suportimi i stafit të ALPEX, duke pasur parasysh rëndësinë e operimit të tregjeve. Ky suport është përshkruar në mënyrë të detajuar në pikën 2.10 “Mbështetja dhe mirëmbajtja” të Termave të Referencës.

Përpara lancimit të operimit në mjedisin real (production) Ofruesi i Shërbimit duhet të vendosë në dispozicion të ALPEX për qëllime të trajnimit të stafit të tij/ALPEX, edhe për qëllim trajnimi të të gjithë Agjentëve Tregtarë të Anëtarëve të Bursës dhe Agjentëve Klerues të Anëtarëve të Klerimit platforma të ngjashme me mjedisin real. Këto Platforma do të shërbejnë për të gjitha zhvillimet në të ardhmen të tregut të energjisë, si kërkesa në nivel rregullator vendor apo Evropian.

Këto ambiente do të shërbejnë për kryerjen e të gjitha testeve nëpër tregjet SDAC dhe SIDC/XBID, pa afektuar ambientin real, i cili do të vijojë pa ndërprerje.

Pas testeve përkatëse, është kërkuar që nga ana e Ofruesit të Shërbimit të dorëzohen të gjitha dokumentet e testeve dhe trajnimeve, në mënyrë që ALPEX ti përdorë këto dokumente për qëllime të brendshme të herë pas herëshme apo në rast të shtimit të stafit të ri.